



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr./Br. 878/20

Data/Datum. 14.12.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.878/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: N.N.P“CTA”SH.P.K,-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës , ku është rekomanduar për kontratë OE: “Avag Group & Enig Com”SH.P.K.-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i kulmit të SH.M.L.T Mehmet Hasi ” me nr. të prokurimit: 651-20-4763-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Gjilan”, më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: N.N.P“CTA”SH.P.K,-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i kulmit të SH.M.L.T Mehmet Hasi ” me nr. të prokurimit: 651-20-4763-5-2-1, iniciuar nga AK- KK-Gjilan,

II.VERTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i kulmit të SH.M.L.T Mehmet Hasi” me nr. të prokurimit: 651-20-4763-5-2-1, iniciuar nga AK- KK-Gjilan,

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: N.N.P“CTA”SH.P.K,-Prishtinë, i aprohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: N.N.P“CTA”SH.P.K,-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 02.11.2020 me nr. 878/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i kulmit të SH.M.L.T Mehmet Hasi” me nr. të prokurimit: 651-20-4763-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Gjilan”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , 10 , 11 , 59 , 60 , 69 , 72 , si dhe nenin 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, dhe nenin 20.3 i RROUPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 04.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 17.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1, Pretendimi i parë i OE ankues është se me date 22.10.2020 kam kërkuar qasje ne dokumente zyrtar për mes emalit Me date 23.10.2020 jam njoftuar se me date 26.10.2020 ne ora 13.15 te jem tek AK qe te me krijohet qasja ne dokumente zyrtar. Kam kërkuar qe te me krijohet qasja me date 23.10.2020 për arsye qe me date 26.10.2020 është dita e 4 dhe nuk kemi shume kohe për ta përgatitur kërkesën për rishqyrtim, mirëpo AK nuk pakthyer përgjigjeje. Me date 26.10.2020 AK nuk me lejon qasje për shkak se OE i shpallur fitues ka plotësuar kërkesën për sekret afarist. Me date 27.10.2020 kam dërguar ne e prokurimi kërkesën për rishqyrtim Me date 27.10.2020 AK me dërgon shkrese për qasje ne dokumente zyrtar. qasja me lejohet me date 28.10.2020 ne ora 14-00 si dhe me kërkohet te plotësohet forma e kërkesë për rishqyrtim .Eksperti shqyrtues bazuar ne nenin 10 Mjetet për promovimin e Transparencës paragrafi 3. ku thotë: 3. Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur..... Gjithashtu sa i përket qeshjes se OE i shpallur fitues ka plotësuar kërkesën për sekret afarist AK-ës është dashur të zbatoj nenin 11 te LPP-së Informatat Sekrete Afariste. ku

thotë: 4. Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e "pastruar" të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas neni paragrafit 3. të neni 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkëngjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste. Eksperti shqyrtues në rastin konkret konstaton se AK është dashur që me kohë ti jap qasje duke përdorur versionin" pastruar "sipas neni 11 të LPP-së.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2, Pretendimi i tjetër i AK- së është se AK ka shkelur Neni 1 të LPP - se pasi nuk ka shfrytëzuar fondet publike në mënyrë efektive pasi që shpërblen me kontrate grupin e OE AVAG GROUP SH.P.K ; EING COM SH.P.K i cili kishte çmimit me të lartë prej të gjithë OE të ofertuar. Çmimi i OE të shpallur fitues është 68,674,41 euro kurse oferta jone ishte me çmimin me të ulët ashtu siç ushte kërkuar në DT dhe njoftimin për kontrate. Çmimi ofertues i kompanisë NNP " CTA " SHPK është 47,237.69 euro kurse i OE i shpallur fitues 68,674,41 euro d.m.th buxheti i shtetit është dëmtuar për 21,436.72 euro ose në përqindje 31.21 % me të lartë se oferta jone

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin në lëndë konstaton se oferta e OE të rekomanduar për kontratë ka çmim me të lartë se oferta e OE ankues. Andaj si i tillë ky pretendim ankimor qëndron.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3, Pretendimi tjetër i OE ankues është se me datën 01.10.2020 kemi pranuar Letrën standarde e kërkesës për sqarim të tenderit ku thuhet: Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim :

Komisioni Profesional për Ekzaminimin dhe Vlerësimin e Ofertave ka konstatuar se në ofertën tuaj më saktësisht tek Dëshmia 2 Për të gjithë personelin profesional OE duhet të dorëzohet këto dëshmi CV - te , Diploma , Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë Project . Ndërsa për personelin teknik OE duhet të dorëzohet këto dëshmi : Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë Project si dhe certifikatat ose diplomat të lëshuara nga institucionet e Republikës së Kosovës .

Është dorëzuar si Saldues, z. Ibrahim Rexhepi ku specifikohet certifikate Helvetas - Swiss Intercooperation. Andaj , kërkojmë nga ju që të na konfirmoni dhe dorëzoni dëshmi të mjaftueshme nëse

ky institucion posedon Licencën nga Republika e Kosovës në mënyrë që të vazhdojmë me Procedura të mëtutjeshme . Përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh me shkrim në adresën e shënuar të autoritetit kontraktues ose në numrin e fix 0280 321 217 apo në e – mailit prokurimi gjilan @ rks gov.net Më së largu deri më datën 05.10.2020 (e hënë) në ora 12:00. Pa përgjigjën nga ana e juaj në pyetjet e lartshënuara Brenda afatit kohor të lartshënuar , tenderi i juaj do të refuzohet . Përgjigje ndaj kërkesës për sqarim të tenderit

Kërkesa nga AK ne DT dhe njoftimin për kontrate te Kapaciteti teknik dhe Professional është : OE ne listën e stafin duhet te këtë edhe staf teknik si Stafin teknik ne këtë përbërje :1 (një) saldues, 1 (një) Admirues, 1 (një) Murator, 1 (një) Molerues, 1 (një) Latues, 1 (një) Suvatim, 1 (një) Ngrohje, dhe 1 (një) Elektroteknike te cilët duhet te jene te certifikuar nga qendra për aftësim profesional të licencuar nga Republika e Kosovës ose ndonjë vend tjetër..

Ne listën e stafit është dorëzuar si Saldues z. Ibrahim Rexhepi ku, është certifikuar nga Helvetas-Swiss Intercooperation KOSOVO nuk është nga Kosova por është nga një vend tjetër e plotëson kërkesën e kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontrate. Mirëpo nëse nuk mjafton kjo dëshmi neve kemi edhe një punëtor te certifikuar si saldues. Ne listën e stafit te kompanisë NPN EUROING SHPK nr:9 punëtori z. Bylbyl GASHI është i punësuar si saldues i certifikuar qe posedon certifikatën e lëshuar nga Instituti Inkos SH.A. AK nuk ka marrë për bazë sqarimin tone pasi qe neve përpos punëtorin te certifikuar si saldator Ibrahim Rexhepi kemi edhe saldator tjetër pasi qe jemi ne koncorzium me kompaninë EURO ING e cila ka saldatorët certifikuar punëtorin Bylbyl GASHI me certifikate te lëshuar nga Instituti INKOS - KOSOVË . Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e AK-së dhe në dokumentacionin në lëndë sqaron se me dt. 22.10.2020 AK ka ngarkuar ne platformën e e-prokurimit, Njoftim Mbi Vendimin E Autoritetit Kontraktues ku ka cekur arsyet e eliminimit të OE ankues, citoj: kërkesë e AK ka qenë.....Në bazë të asaj çfarë u cek më lartë janë kërkuar mjeshtrit të kenë diploma të lëshuar nga Institucione e Republikës së Kosovës, edhe pse ne ju kemi drejtuar juve me Letër Sqaruese lidhur me Qendrën e cila e ka lëshuar certifikatën a ka Licence te veprimtarisë nga Institucionet e Republikës së Kosovës. Ju si Operator Ekonomik nuk na keni sjellë ashtu siç është kërkuar dhe si përfundim nuk e ka plotësuar këtë kërkesë sipas DT, po ashtu mjeshtrin Fazli Gjyliqin e ka të njëjtin edhe Armirues dhe Latues , ndërsa në DT është kërkuar të jen ndaras, një Latues dhe 1 Armirues. Sa i përket kësaj pike ankimore eksperti shqyrtues bazuar në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar dhe dokumentacionin në lëndë, konstaton se në ofertën e grupit të OE ankues punëtori Bylbyl GASHI posedon certifikate të lëshuar nga Instituti INKOS – KOSOVË, si Saldues qe e plotëson kërkesën e AK pa e marr për bazë certifikatën e kontestuar nga ana e AK-së për punëtorin Ibrahim Rexhepi. Dhe si e tillë kjo arsye e eliminimit nuk qëndron.

Më tej eksperti shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin në lëndë në RRUOPP neni 39. Sqarimi i Tenderëve paragrafi 39.1 thotë: Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK “Kërkesë për sqarim të tenderit”. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike. Eksperti shqyrtues bazuar ne nenin e lartcekur sqaron se AK është dashur të kërkoj sqarime përmes formularit standard B47 sqarimet e tenderit përmes platformës elektronike, ku në rastin konkret AK nuk ka kërkuar sqarim te tenderit përmes platformës elektronike gjithashtu as nuk ka kërkuar të marr përgjigjeje përmes platformës elektronike.

Me tej eksperti shqyrtues sqaron se në listën e punëtorëve të dorëzuar nga OE N.P.N “Euroing”ku është në konzercium me OE NNP “CTA”SH.P.K listë e cila është e bashkangjitur në ofertë ne nr. rendor 10 punëtori Çlirim Gashi, tek Profesioni figuron Armirues i kualifikuar. Neni 39.3 i RRUOPP-së thotë: Megjithatë, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, te cilat mungojnë ne aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, ne mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit te Njoftimit për kontrate. Ku në rastin konkret mund te kërkohet sqarim rreth punëtorit Çlirim Gashit.

Përgjigje në Pretendimi nr. 4, Pretendimi tjetër i OE ankues është se AK na ka eliminuar për arsye se punëtori – mjeshtri Fazli Gjyliqin e ka të njëjtin edhe Armirues dhe Latues , ndërsa në DT është kërkuar të jenë ndaras , një Latues dhe 1 Armirues . Punëtori Fazli Gjyliqi ka diploma te lëshuar nga qendrat e aftësimit Professional edhe atë ne lëmin e ndërtimtarisë si : * Armirues * Latues ne kemi para kontrate për projektin ne fjale edhe për pozitën e armiruesit dhe për pozitën e latuesit . Pika tjetër ankimore është se specifikimet teknike nuk kanë qen te njëjta me natyrën e aktivitetit te prokurimit pasi qe ne paramasen ofertuese nuk ka qen asnjë pozicion i cili duhet te kryhet nga armiruesi , kjo ka qen një kërkesë e pa nevojshme . Sikur te kishte pozite të armaturës ne paramasen ofertuese punëtorin Fazli Gjyliqi pasi kemi dy para kontrata ne dosje si armirues dhe si latues do te kishim angazhua me orar pune 50 % silatues dhe 50 % si armirues . Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne kërkesat e AK-së dhe dokumentacionin në lëndë konstaton se kërkesë e AK-së ka qenë: Stafin teknik ne këtë përbërje : 1 (një) saldues, 1 (një) Armirues, 1 (një) Murator, 1 (një) Molerues, 1(një) Latues, 1 (një) Suvatim, 1 (një) Ngrohje, dhe 1 (një) Elektroteknike te çilet duhet te jene te certifikuar nga qendra për aftësim profesional të licencuar nga Republika e Kosovës ose ndonjë vend tjetër. Bazuar në kërkesën e AK eksperti shqyrtues sqaron, sa i përket pikës ankimore rreth kërkesave të panevojshme OE ka pasur të drejtë të paraqes kërkesë pran AK-së bazuar në DT tek pika 16.1 Sqarimi i Dosjes së Tenderit deri me datën 02.09.2020. Qëndron fakti se në paramase për këtë AP nuk ka as një pozicion qe duhet të kryhet nga Armiruesi ku eksperti shqyrtues konstaton se nuk është pengesë për kryerjen e

punëve meqenëse z. Fazli Gjyliqi posedon certifikimin e duhur dhe ka para kontrata të lidhura për këtë projekt me OE në fjalë si Armirues dhe si Latues. Prandaj bazuar në sqarimet që u dhanë më lartë del se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 5, Pretendimi tjetër i OE ankues është se Grupi i OE të shpallur fitues AVAG GROUP SH.P.K ; EING COM SH.P.K. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale 9.1 dhe 9.2 të FDT dhe njoftim për kontrate nga AK janë : Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme gjate 3 vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 150.000,00 €.. Dëshmia 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve OE - ENIG COM sh.p.k ka dorëzuar listën të vulosur dhe nënshkruar me 5 kontrata ku të gjitha këto 5 kontrata janë kontrata të ndërtimit të ulët d.m.th janë parqe , rregullim i hapësirës publike. asnjëra nga këto kontrata nuk është e njëjtë me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Në të njëjtën kohë ka dorëzuar edhe një listë duke mos e plotësuar aneksin 6 të DT. Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e AK dhe dokumentacionin e dorëzuar nga ana e Grupit të OE-ik OE- AVAG GROUP & ENIG COM sh.p.k në këtë AP konstaton se lista e kontratave të realizuar nga ana e OE ENIG COM sh.p.k, është e nënshkruar dhe e vulosur nga e OE, është plotësuar Aneksi 6 i DT siç ka qenë obligative nga ana e AK-së , ndërsa sa i përket kontratave të realizuara në këtë listë eksperti shqyrtues sqaron se të gjitha kontratat në fjalë kanë të bëjnë me ndërtimin e ulët. Gjithashtu eksperti shqyrtues sa i përket listës tjetër të dorëzuar nga ana e po të njëjtit OE - ENIG COM, sqaron se OE nuk ka përdorur Aneksin 6 Kriteret për Dhënie të Kontratës. Lista e kontratave të realizuara në 3 vitet e fundit ku ka qen obligative nga ana e AK që të plotësohet Aneksi 6 por OE ka dorëzuar një tjetër listë. Mirëpo në oferte të OE AVAG GROUP ka të bashkëngjitur listën e kontratave duke përdorur Aneksin 6 e nënshkruar dhe e vulosur sipas kërkesës së AK, e cila listë si dëshmi për realizim ka të bashkëngjitur kontratën dhe referencën. Eksperti shqyrtues bazuar në vlerën e lejuar +/- 30% konstaton se e plotëson kërkesën e AK-së. Andaj eksperti shqyrtues vjen në përfundim se ky pretendim i OE ankues është i pabazuar. Pika tjetër ankimore ku thuhet se OE- AVAG GROUP sh.p.k në listën në Aneksin 6 ka të plotësuar listën e kontratave ku kjo kontratë është Mirëmbajtja teknike e objekteve në të gjitha njësitë kërkuese të Komunës së Gjilanit , kjo kontratë nuk është kontratë e njëjtë me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Po ashtu vlen të theksohet OE ka manipuluar me çmimin e kësaj kontrate pasi që në e-prokurim ky aktivitet i prokurimit ka vlerën 237,029.65 euro kurse OE ka falsifikuar në 924,415.63 euro. Kjo dëshmi është në platformë e-prokurimi me nr. prok ; GL651-18 2551-511.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin në lëndë dhe në titullin e kontratës në fjalë sqaron se kjo kontratë ka të bëjë me renovime të objekteve që hynë në kategorinë e ndërtimit të lartë dhe si e tillë e

plotëson kërkesën e AK-së. Sa i përket kësaj pike ankimore eksperti shqyrtues sqaron se në dëshminë (kontratën dhe referencën) e bashkangjitur në ofertën e OE fitues sqarohet shumë mirë se vlera e kontratës për një vit ka qenë 237,029.65 euro, gjithashtu në kontratë sqarohet se kontrata është 3 vjeçare dhe devijimi i lejuar nga vlera indikative është +/- 30%. Nga kjo rrjedh se $237,029.65 * 3\text{vite} = 711,088.95 + 30\% = 924,415.63$ vlera totale e realizuar e dëshmuar edhe me referencë. Prandaj duke u bazuar në sqarimet me lartë del se kjo pikë ankimore nuk qëndron. Andaj eksperti shqyrtues bazuar në RRUOPP-në konstaton se AK-ës që gjatë rivlerësimit mund të zbatohet nenin 39 paragrafi 39.1 të RRUOPP-së, për çdo paqartësi lidhur me tenderin e paraqitur nga OE mirëpo gjithmonë duke u bazuar në LPP-në dhe RRUOPP-në.

Mendimi i ekspertit shqyrtues, Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Ri Vlerësim**.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 18.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 20.11.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Paneli shqyrtues pas analizës së rastit në tërësi si dhe vlerësimit të gjitha fakteve dhe provave gjeti se nuk egzistojnë të bazuara asnjëra nga pretendimet ankimore të ushtruara në ankesë nga OE ankues **OE NNP CTA SH.P.K.; NPN EUROING SH.P.K.** ndaj vendimit të AK- Komuna e Gjilanit për dhënie të kontratës OE "AVAG GROUP & EING COM" SHPK.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në faktet e gjetura konstaton se AK-ja tenderin e OE ankues e ka eliminuar në mënyrë të drejtë, për shkak se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes sipas kërkesave teknike dhe ose profesionale të cilat janë specifikuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Rrjedhimisht ankuesi nuk ka plotësuar kriterin e dhënies së kontratës të tenderuesit të përgjegjshëm me çmim më të ulët i cili është i vendosur në nenin 60 të LPP-së

Lidhur me pretendimin e parë të OE ankues se me date 22.10.2020 kam kërkuar qasje në dokumenta zyrtar për mes emailit Me date 23.10.2020 ja njoftuar se me date 26.10.2020 në ora 13.15 te jem tek AK për arsye që më datë 26.10.2020 është dita e 4 dhe nuk kemi shumë kohe për ta përgaditur kërkesen për rishqyrtim, mirpo AK nuk ka kthyer përgjigjeje. Me date 26.10.2020 AK nuk me lejon qasje për shkak se OE i shpallur fitues ka plotësuar kërkesen për sekre afarist. Me date 27.10.2020 kam dërguar në eprokurimi kërkesen për rishqyrtim Me date 27.10.2020 AK me dërgon shkresë për qasje në dokumenta zyrtar. qasja me lejohet me date 28.10.2020 në ora 14-00 si dhe me kërkohej të plotsohet forma e kërkesë për rishqyrtim.

Eksperti shqyrtues bazuar në nenin 10 Mjetet për promovimin e Transparencës paragrafi 3. ku thotë :3. *Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur.....* Gjithashtu sa i perket qeshtjes se OE I shpallur fitues ka plotësuar kërkesen për sekret afarist AK-së është dashur të zbatohet nenin 11 të LPP-së Informatat Sekrete Afriste. ku thote:

4. Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e "pastruar" të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versionin e pastruar i bashkëngjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste. Eksperti shqyrtues në rastin konkret konstaton se AK është dashur që më kohë ti jap qasje duke përdorur versionin "pastruar" sipas nenit 11 të LPP-së

Lidhur me këtë pikë paneli shqyrtues duke u bazuar në faktet dhe provat e gjetura me rastin e

dokumentacionit të shqyrtuar nga dosja e tenderit të OE ankues, konstaton se është i pabazë pretendimi i ushtruar në ankesë për shkak se OE ankues iu është dhënë qasja zyrtare në tenderin e OE të rekomanduar me dhënien e kontratës konform nenit 10 të LPP-së dhe duke marrë për bazë kërkesën për sekret afarist të OE fitues konform kërkesave ligjore të nenit 11 të LPP-së. **Paneli konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.**

Lidhur me pretendimin dytë se AK ka shkelur Neni 1 të LPP-së pasi nuk ka shfrytëzuar fontet publike në menyrë efektive pasi që shpërblen me kontratë grupin e OE OE "AVAG GROUP & EING COM" SHPK. i cili kishte çmimit më të lartë prej të gjithë OE të ofertuar. Çmimi i OE të shpallur fitues është 68,674.41 euro kurse oferta jon ishte me çmimin më të ulët ashtu siç është kërkuar në DT dhe njoftimin për kontratë. Çmimi ofertues i kompanisë NNP"CTA"SHPK është 47,237.69 euro kurse i OE i shpallur fitues 68,674.41 euro dmth buxheti i shtetit është dëmtuar për 21,436.72 euro ose në përqindje 31.21 % më të lartë se oferta jonë.

Lidhur me këtë pikë paneli shqyrtues duke u bazuar në faktet dhe provat e gjetura me rastin e dokumentacionit të shqyrtuar nga dosja e tenderit të OE ankues, konstaton se është i pabazë pretendimi i ushtruar në ankesë për shkak se OE ankues ka dorëzuar tender të papërgjegjshëm në kuptim të kërkesave ligjore nga neni 56 dhe neni 59.4 i LPP-së për faktin se nuk i ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes sipas kërkesave teknike dhe ose profesionale të cilat janë specifikuar pikën 9.1&9.2 të FTD-së në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Po ashtu paneli shqyrtues sqaron se AK në dosjen e tenderit kriter për dhënien e kontratës e ka përcaktuar tenderit të përgjegjshëm me çmim më të ulët. Në rastin paneli sqaron se konkret OE ankues nuk e ka plotësuar këtë kriter për faktin se tenderi i tij nuk ka qenë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit e cila është kërkesë qenësore sipas nenit 59.4 të LPP-së. Andaj paneli konstaton se nuk ekzistojnë shkaqet e shkeljes së nenit 1 të LPP-së siç pandeh OE ankues, për shkak se AK me dhënien e kontratës e ka mbështetur në zbatim të kushteve dhe rregullave ligjore nga neni 59 dhe neni 60 i LPP-së që është edhe kërkesë e qëllimit të prokurimit nga neni 1.1 të LPP-së. **Paneli konstaton se ky pretendim është i pabazuar.**

Lidhur me pretendimin e tretë dhe katërt të OE ankues, se me datën 01.10.2020 kemi pranuar Letrën standarde e kërkesës për sqarim të tenderit ku thuhet :për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimi të tenderit të juaj si ne vijim:

Komisioni Profesional për Ekzaminimin dhe Vlerësimin o Ofertave ka konstatuar se në ofertën tuaj më saktësisht tek Dëshmia 2 Për të gjithë personelin profesionalë OE duhet të dorëzohj këto dëshmi CV-të,

Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë Project. Ndërsa për personalin teknik OE duhet të dorëzoj këto dëshmi: Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshje mbi angazhimin për këtë projekt si dhe certifikatat ose diplomat të lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Është dorëzuar si Saldues, Ztr.Ibrahim Rexhepi i specifikohet certifikata Helvetas-Swiss intercooperation. Andaj, kërkojmë nga ju që të na konfirmoni dhe dorëzoni dëshmi të mjaftueshme nëse ky institucion posedon Licencën nga Republika e Kosovës në mënyrë që të vazhdojmë me Procedura të mëtutjeshme.

Përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh me shkrim në adresën e shënuar të autoritetit kontraktues ose në numrin e fix 0280 321 217 apo në e-mailit prokurimigjilan@rks-gov.net Më së largu deri më datën 05.10.2020 (e hënë) në ora 12:00.Pa përgjigjen nga ana e juaj në pyetjet e lartshënuara Brenda afatit kohor të lartshënuar, tenderi i juaj do të refuzohet.

Përgjigjja ndaj kërkesës për sqarim të tenderit

Kërkesat nga AK ne DT dhe njoftimin per kontrate te Kapacitetit teknik dhe profesional është : OE ne listën e stafit duhet te këtë edhe staf teknik si Stafin teknik ne këtë perberje:1(një) saldues, 1 (një) Armirues, 1 (nje) Murator, 1 (një) Molerues, 1 (një) Latues , 1 (një) Suvatim, 1(një) Ngrohje, dhe 1 (një) Elektroteknike te cilët duhet te jene te certifikuar nga qendra për aftësim profesional të licencuar nga Republika e Kosovës ose ndonjë vend tjetër..

Ne listën e stafit është dorëzuar si Saldues z. Ibrahim Rexhepi ku është certifikuar nga Helvetass-Sëiss intercooperation KOSOVO nuk është nga Kosova por është nga një vend tjetër e plotëson kërkesën e kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimit per kontrate. Mirëpo nëse nuk mjafton kjo dëshmi neve kemi edhe një punëtor të certifikuar si saldues. Në listën e stafit të kompanisë NPN EUROING SHPK nr.9 Punëtori z.Bylbyl GASHI është I punësuar si saldues I certifikuar që posedon certifikatën e lëshuar nga Instituti Inkos SH.A. AK nuk ka marrë për bazë sqarimin tonë pasi që neve përpos punëtorin e certifikuar si saldator Ibrahim REXHEPI kemi edhe saldator tjerë pasi që jemi në konzorcium me kompaninë INKOS-KOSOVË.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e AK-së dhe në dokumentacionin në lëndë sqaron se me dt. 22.10.2020 AK ka ngarkuar në platformën e e-prokurimit, Njoftim Mbi Vendimin E Autoritetit Kontraktues ku ka cekur arsyet e eliminimit të OE ankues, citoj: kërkesë e AK ka qenë... Në bazë të asaj cfar u cek më lartë janë kërkuar mjeshtërit të kenë diploma të lëshuar nga Institucione e Republikës së Kosovës, edhe pse ne ju kemi drejtuar juve me Letër Sqaruese lidhur me Qendrën e cila e ka lëshuar certifikatën a ka Licence të veprimtarisë nga Institucionet e Republikës së Kosovës. Ju si Operator Ekonomik nuk na keni sjellë ashtu siç është kërkuar dhe si përfundim nuk e ka plotësuar këtë kërkesë sipas DT, po ashtu mjeshterin Fazli Gjyliqin e ka të njëjtin edhe Armirues dhe Latues, Ndërsa në DT është

kërkuar të jenë ndaras, një Latues dhe një Armirues.

Sa i përket kësaj pike ankimore eksperti shqyrtues bazuar në letrën standard për tenderuesin e eliminuar dhe dokumentacionin në lëndë, konstaton se në ofertën e grupit OE ankues punëtori Bylbyl Gashi posedon certifikatë lëshuar nga Instituti INKOS – KOSOVË, si Saldues që e plotëson kërkesën e AK pa e marr për bazë certifikatën e konstatuar nga ana e AK-së për punëtorin Ibrahim REXHEPI. Dhe si e tillë kjo arsye e eliminimit nuk qëndron.

Më tej eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin në lëndë në RRUOPP neni 39. Sqarimi I Tenderëve paragrafi 39.1 thotë: Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK munde të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një sqarim formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK “Kërkesë për sqarim të tenderit”. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platëformës elektronike. Eksperti shqyrtues bazuar në nenin e lartcekur sqaron se AK është dashur të kërkoj sqarime përmes formularit standard B47 sqarimet e tenderit përmes platformës elektronike, ku në rastin konkret AK nuk ka kërkuar sqarim të tenderit përmes platformës elektronike gjithashtu as nuk ka kërkuar të marrë përgjigje përmes platformës elektronike.

Më tej eksperti shqyrtues sqaron se në listën e punëtorëve të dorëzuar nga OE N.P.N “Euroing” ku është në konzercium me OE NNP “CTA” SH.P.K listë e cila është bashkëngjitur në ofertë nr. Rendor 10 punëtori Çlirim Gashi, tek profesioni figuron Armirues I kualifikuar. Neni 39.3 I RRUOPP-së thotë:

Megjithatë, nuk lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objective duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të njoftimit për kontratë. Ku në rastin konkret mund të kërkohet sqarim rreth punëtorit Çlirim Gashit.

Pretendimi katërt I OE ankues është se AK na ka eliminuar per arsye se punëtori-mjeshtri Fazli Gjyliqin e ka të njëjtin edhe Armirues dhe Latues, ndërsa në DT është kërkuar të jenë ndaras, një Latues dhe I Armirues. Puntori Fazli Gjyliqi ka diploma te lëshuar nga qendrat e aftesimit professional edhe ate ne lemin e ndertimtarise si : *Armirus * Latues ne kemi parakontrate per projektin ne fjale edhe per poziten e armirusite dhe per poziten e latuesit.

Pika tjetër ankimore është se specifikimet teknike nuk kanë qen te njëjta me natyrën e aktivitetit te prokurimit pasi qe ne paramasen ofertuese nuk ka qen asnjë pozicion I cili duhet te kryhet nga armiruesi, kjo ka qen një karkës e pa nevojshme. Sikur te kishte pozite të armatures ne paramasen

ofertuese punëtorin Fazli Gjyliqi pasi kemi dy para kontrata ne dosje si armirues dhe si latues do te kishim angazhu me orar pune 50% si latues dhe 50% si armirues.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne kërkesat e AK-së dhe dokumentacionit në lënde konstaton se kërkesë e AK-së ka qenë: Stafin teknik ne këtë përbërje: 1(një) saldues, 1 (një) Armirues, 1 (një) Murator, 1 (një) Molerues, 1 (një) Latues, 1 (një) Suvatim, 1(një) Ngrohje, dhe 1 (një) Elektroteknike te cilët duhet te jene te certifikuar nga qendra per aftësim profesional te licencuar nga Republika e Kosovës ose ndonjë vend tjetër.

Bazuar në kërkesën e AK eksperti shqyrtues sqaron, sa i përket pikës ankimore rreth kërkesave të panevojshme OE ka pasur të drejtë të paraqes kërkesë pran AK-së bazuar në DT tek pika 16.1 Sqarimi I Dosjes së Tenderit deri me datën 02.09.2020.Qëndron fakti se në paramasë për këtë AP nuk ka as një pozicion qe duhet të kryhet nga Armiruesi ku eksperti shqyrtues konstaton se nuk është pengës për këtë projekt me OE në fjalë si Armirues dhe si Latues. Prandaj bazuar në sqarimet që u dhan më lartë del se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me këtë çështje të ushtruar në ankesë në pretendimin tre dhe katër, paneli shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit tek kërkesa kapacitetit teknik dhe/ose profesional lidhur me stafin profesional është kërkuar: *“OE në listën e stafit duhet të ketë edhe staf teknik në përbërje: 1 (një) saludes, 1 (një) Armirues, q (një) Murator. 1 (një) Molerues, 1 (një) Latues, 1 (një) Suvatim, 1 (një) ngrohje dhe 1 (një) Elektroteknikë të cilët duhet të jetë të certifikuar nga qendra për aftësim profesional të licencuar nga Republika e Kosovës.”*

Në ofertën e dorëzuar nga grupi i OE ankues për ta plotësuar kërkesën për Saldues ka paraqitur stafin Ibrahim Rexhepi i certifikuar nga Helvetas Swiss Intercooperation. Më tutje lidhur me këtë çështje paneli sqaron se AK gjatë fazës vlerësimit OE ankues i ka kërkuar sqarime përkitazi me aspektin e certifikatës së salduesit Ibrahim Rexhepi pasi që e njëjta nuk është e lëshuar nga një Qendër për Aftësim Profesional të licencuar në Republikën e Kosovës ose ndonjë vend tjetër. OE ankues ka sqaruar se salduesi i paraqitur Ibrahim Rexhepi ka vetëm certifikate nga Helvetas Sëiss Intercooperation dhe në vazhdim ka përmendur se në listën e stafit të grupit NPN EUROING SHPK, punëtori Bylbyl Gashi i punësuar si saldues posedon certifikatën e lëshuar nga Instituti Inkos SH.A. Në vazhdim lidhur me kërkesën e armirues dhe kërkesën latues të cilat janë kërkesa ndaras njëra me tjetrën, OE që ka ushtruar ankesë për të dy këto kërkesa e ka paraqitur stafin Fazli Gjyliqi i cili ka diplomë të lëshuar nga Qendra e Aftësimit Profesional në lëminë e ndërtimeve.

Paneli sqaron se AK e ka eliminuar tenderin e OE ankues me shkaqet se nuk e ka plotësuar kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht kërkesën për stafin profesional për saldues, armirues dhe latues siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues lidhur me këtë pikë duke u bazuar në faktet dhe provat e gjetura me rastin e dokumentacionit të shqyrtuar nga dosja e tenderit të OE ankues si dhe nga sqarimet të cilat ankuesi i ka bërë deri me datën 05.10.2020, konstaton që është i pabazë pretendimi nr. 3 dhe 4 i ushtruesit të ankesës.

Lidhur me çështjen e stafit profesional saldues ku ushtruesi i ankesës për plotësimin e kërkesës për staf armirues e ka paraqitur Ibrahim Regjepi i cili ka certifikatë nga Helvetas Sëiss Intercooperation, paneli shqyrtues konstaton se ushtruesi i ankesës nuk e ka plotëuar kërkesën e AK-së përkitazi me stafin profesional armirues për shkak se në përgjigjen e tij ndaj kërkesës për sqarim të tenderit, sqarimin që e ka dhënë nuk e ka mbështetur dhe vërtetuar me asnjë provë materiale se Helvetas Swiss Intercooperation është e licencuar si Qendër e Aftësimit Profesional për lëshimin e certifikatave. Po ashtu paneli konstaton se ushtruesi i ankesës gjatë fazës së sqarimit nuk ka ofruar asnjë provë materiale me të cilën do ta mbështet se certifikata e lëshuar nga Helvetas Sëiss Intercooperation për Ibrahim Regjepin është e pranuar në pajtim me ligjet e Kosovës që rregullojnë fushën e aftësimeve, trajnimeve profesionale në Republikën e Kosovës.

Lidhur me stafin profesional Fazli Gjyliqi të cilin e ka prezantuar për si staf profesional latues dhe armirues, paneli shqyrtues konstaton se ushtruesi i ankesës nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-së për faktin se këto janë dy kërkesa të cilat janë të ndara njëra me tjetrën në dosjen e tenderit. Andaj paneli sqaron se për t'i plotësuar njërin dhe tjetrën parashtruesi i ankesës është dashur që të ofrojë dëshmi se e ka stafin profesional veç e veç edhe për njërin edhe për tjetrën.

Po ashtu paneli shqyrtues sqaron se përkitazi me të dy pretendimet, ushtruesi i ankesës ka marrë kërkesë nga AK që brenda një afati të arsyeshëm kohor për të sqaruar këto dy pika kontestuese të tenderit. Konform kërkesave ligjore nga neni 72 të LPP-së sqarimi nënkupton edhe plotësimin e dokumenteve specifike nga të cilat mund të kompletohet informacioni i duhur për dokumentet ekzistenca e të cilave është fiksuar para skadimit të afatit për dorëzim të tenderëve. OE ankues ka dështuar që sqarimet e tij t'i mbështes duke i plotësuar e vërtetuar me prova materiale (dokumente specifike). Andaj paneli shqyrtues duke u bazuar edhe në nenin 39 pika 7 e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, konstaton se AK me të drejtë e ka refuzuar tenderin e ushtruesit të ankesës. **Paneli konstaton se ky pretendim është i pabazuar.**

Kërkesa 2 Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme dhe ate :

Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë ose master , drejtimi konstruktiv me se paku 5 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) .

Udhëheqës i punishtes Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë ose master drejtimi konstruktiv,ose me se paku 2 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit);

Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) ose gjeodet (shkolla e lartë), ose Bahcelor i diplomuar i gjodezisë me pesë vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit);

Një (1) Inxhinier i diplomuar i makineris ose master me pes vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) ;

Dy Teknik të dip të ndërtimtarisë, me- pes vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) dhe OE ne listen e stafin duhet te kete edhe staf teknik si **Stafin teknik ne kete perberje :**

1 (nje) saldues,

1 (nje) Armirues,

1 (nje) Murator,

1 (nje) Molerues,

1 (nje) Latues,

1 (nje) Suvatim,

1 (nje) Ngrohje, dhe

1 (nje) Elektroteknike te cilet duhet te jene te cerfikuar nga qendra për aftësim profesional të licencuar

nga Republika e Kosoves ose ndonje vend tjeter.

Dëshmia 2 Për te gjithë personelin profesional OE duhet te dorezoj keto deshmi CV-te, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë project. Ndersa per personelin teknik OE duhet te dorezoj keto deshmi Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë project si dhe certifikatat ose diplomat të lëshuara nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Lidhur me Pretendimin e pestë të OE ankues se Grupi I OE të shpallur fitues AVAG GROUP SH.P.K ; EING COM SH.P.K. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale 9.1 dhe 9.2 të FDT dhe njoftim për kontratë nga AK janë:

Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme gjatë 3 vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontrat. Në një vlerë prej jo më pak se 150,000.00 €..

Dëshmia 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.

OE – EING COM shpk ka dorëzuar listën të vulosur dhe nënshkruar me 5 kontrata ku të gjitha këto 5 kontrata janë kontrata të ndërtimit të ulët dmth janë parqe, rregullim I hapësirës publike. Asnjëra nga këto kontrata nuk është e njëjtë me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Në të njëjtën kohë ka dorëzuar edhe një listë duke mos e plotësuar aneksin 6 të DT.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e AK dhe dokumentacionin e dorëzuar nga ana e Grupit të OE- AVAG GROUP SH.P.K & EING COM SH.P.K. në këtë AP konteston se lista e kontratave të realizuar nga ana e OE- EING COM sh.p.k, është e nënshkruar dhe e vulosur na e OE, është plotësuar Aneksi 6 I DT siq ka qenë obligative nga ana e AK-së, ndërsa sa i përket kontratave të realizuara në këtë listë eksperti shqyrtues sqaron se të gjitha kontratat në fjalë kanë të bëjnë me ndërtimin e ulët. Gjithashtu

eksperti shqyrtues sa i përket listës tjetër të dorëzuar nga ana e të njëjtit OE – EING COM sh.p.k, sqaron se OE nuk ka përdorur Aneksin 6 Kriteret për Dhënien e Kontratës. Lista e kontratave të realizuara në 3 vitet e fundit ku ka qen obligative nga ana e AK që të plotësohet Aneksi 6 por OE ka dorëzuar një tjetër listë. Mirëpo në ofertë e OE AVAG GROUP sh.p.k ka të bashkëngjitur listën e kontratave duke përdorur Aneksin 6 e nënshkruar dhe vulosur sipas kërkesës së AK, e cila listë si dëshmi për realizim ka të bashkëngjitur kontratën dhe referencën. Eksperti shqyrtues bazuar në vlerën e lejuar +/- 30% konstaton se e plotëson kërkesën e AK-së. Andaj eksperti shqyrtues vjen në përfundim se ky pretendim I OE ankues është I pabazuar.

- Pika tjetër ankimore ku thuhet se OE – AVAG GROUP shpk në listën në Aneksin 6 ka të plotësuar listën në Aneksin 6 ka të plotësuar listën e kontratave ku kjo kontratë është Mirëmbajtja teknike e objekteve në të gjitha njësitë kërkuese të Komunës së Gjilanit, kjo kontratë nuk është kontratë nuk është kontratë e njëjtë me natyrën e aktivitetit të prokurimit.

Po ashtu vlen të theksohet OE ka manipuluar me çmimin e kësaj kontrate pasi që në eprokurim ky aktivitet i prokurimit ka vlerën 237,029.65 euro kurse OE ka fallsifikuar në 924,415.63 euro. Kjo dëshmi është në platform eprokurimi me nr.prok; GL651-18 2551-511.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin në lënd dhe titullin e kontratës në fjalë sqaron se kjo kontratë ka të bëjë me renovime të objekteve që hynë në kategorinë e ndërtimit të lartë dhe si e tillë e plotëson kërkesën e AK-së. Sa i përket kësaj pike ankimore eksperti shqyrtues sqaron se në dëshmin (kontratën dhe referencën) e bashkëngjitur në ofertën e OE fitues sqarohet shume mirë se vlera e kontratës për një vit ka qenë 237,029.65 euro, gjithashtu në kontratë sqarohet se kontrata është 3 vjeçare dhe devijimi i lejuar nga vlera indicative është +/- 30%. Nga kjo rrjedhë se $237,029.65 * 3\text{vite} = 711,088.95 + 30\% = 924,415.63$ vlera totale e realizuar e dëshmuar edhe me referencë. Prandaj duke u bazuar në sqarimet më lartë del se kjo pikë ankimore nuk qëndron.

Paneli shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit tek kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesional është kërkuar: *Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme gjatë 3 viteve të fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontrat në një vlerë prej jo më pak se 150.000,00€.* Dëshmia 1. *Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku thuhet saktësuat titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesit, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.*

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin në lende dhe titullin e kontratës në fjalë sqaron se

kjo kontratë ka të bëjë me renovime të objekteve që hynë në kategorinë e ndërtimit të lartë dhe si e tillë e plotëson kërkesën e AK-së. Sa i përket kësaj pike ankimore ekspertit shqyrtues sqaron se në dëshminë (kontratën dhe referencën) e bashkëngjitur në ofertën e OE fitues sqarohet shumë mirë se vlera e kontratës për një vit ka qenë 237,029.65 euro, gjithashtu në kontratë sqarohet se kontrata është 3 vjeçare dhe devijimi i lejuar nga vlera indicative është +/- 30%. Nga kjo rrjedhë se $237,029.65 * 3 \text{ vite} = 711,088.95 + 30\% = 924,415.63$ vlera totale e realizuar e dëshmuar edhe me referencë. Prandaj duke u bazuar në sqarimet më lartë del se kjo pikë ankimore **nuk qëndron**.

Paneli shqyrtues konform provave dhe fakteve të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor nga dokumentacioni i dosjes dhe konform ekspertit shqyrtues, konstaton se nuk egzistojnë asnjëri nga shkaqet që i ka paraqitur ushtruesi i ankesës. Nga dëshmitë (kontratat dhe referencat) të bashkëngjitur në dosjen e tenderit të grupit të OE AVAG GROUP & EING COM SHPK e ka plotësuar në tërësi dhe madje tejkaluar kërkesën e AK-së. Dëshmitë dokumentare (referencat) të cilat OE ankues i ka bashkëngjitur në dosjen si për nga titulli i lëndës e po ashtu për nga përmbajtja, tregojnë rezultatin se objekti i lëndës së realizimit nga këto kontrata është i ngjajshëm dhe identik me lëndën e kësaj kontrate. Po ashtu paneli konform ekspertit shqyrtues sqaron se bazuar në kontratën dhe referencën sqarohet shumë mirë se vlera e kontratës për një vit ka qenë 237,029.65€, gjithashtu në kontratë sqarohet se ajo është tre (3) vjeçare dhe devijimi i lejuar nga vlera indicative është +/- 30%. Nga kjo rrjedh se $237,029.65€ \times 3 \text{ vite} = 711,088.95€ + 30\% = 924,415.63$ vlera totale e realizuar e dëshmuar edhe me referencë.

Për më tepër lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi përkitazi me anëtarin e grupit të OE fitues, paneli shqyrtues sqaron se konform nenit 71 të LPP-së dhe nenit 27 pika 3 të RRUOPP përcaktohet në mënyrë shumë të qartë, të kuptueshme se: **Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të LPP-se do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.**

Paneli konstaton se ky pretendim është i pabazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, duke rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik që ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ofertuar me çmim me te lire nga te gjithë ofertuesit e përgjegjshëm. Dhe se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave i është përmbajtur në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - "KK-Gjilan",
- 1x1 OE – N.N.P"CTA"SH.P.K.-Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.